

VENDIM
Nr.628, datë 24.12.1999

**PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË PËR BLERJEN E PAJISJEVE SPECIALE PËR
FORCAT SPECIALE DHE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË TË MINISTRISË SË RENDIT
PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurim publik”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ministria e Rendit Publik të prokurojë fondin prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë, me firmën maqedonase-amerikae “MICEI INTERNATIONAL” për blerjen e pajisjeve speciale për forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë të kësaj ministrie, sipas listës së çmimeve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA E ARTIKUJVE QË DO TË PROKUROHEN

1	Pushkë snajper “Remington” me shënjestër optike ditë dhe natë	5 copë	9 500 USD/copa
2	Shotgun model 870 mm me karikator të rrotullueshëm	5 copë	590 USD/copa
3	Shotgun model 37x40	6 copë	1 450 USD/copa
4	Shigjetë hedhës, hark	2 copë	740 Dem/copa
5	Granada shurdhuese verbuee	200 copë	45 USD/copa
6	Granada me gaz CN-cs	200 copë	45-112/copa
7	Municion gome për shotgun	1000 copë	780 USD/100 copa
8	Municion për shotgun 37x40 mm me gaz CS	400 copë	80-90 Dem/copa
9	Hapës hidraulik dyresh	2 copë	3 500 USD/copa
10	Dylbi nate	4 copë	750 USD/copa